

A



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org Org. Jedinica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot Broj. Prot Prot. No.	4875-3/25
Nr. I faqeve Broj. stranica No. pages	- 03 -
Data Datum Date	02.09.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	24.08.2026
REFERENC-Ë:	25/4875-3/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Floris Dorian" SH.p.k, Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën e pranuar nga kompania e juaj për korrigjimin e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor, me nr.prot.: 24/4875-3/DMM të datës 10.07.2026 dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për korrigjimin e Vendimit për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Floris Dorian" SH.P.K. Istog, me nr prot.: 25/4875/ZSP/ /25 të datës 22.09.2025, për Impiantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore në Istog, në ngastrën kadastrale nr. P-70806044-00897-2 në ZK Sinajë, Komuna Istog.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura; paragrafin 1, të nenit 50, të Ligjit Nr. 05/L-031, Per Procedurën e Përgjithshme Administrative; nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nxjerr këtë:

V E N D I M

Korrigjohet Vendimi i Pëlqimit Mjedisor me nr.prot.: 25/4875/ZSP/ /25 të datës 22.09.2025 për Kompaninë "Floris Dorian" Sh.p.k, Istog, për Impiantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore me djegëje në temperatura të larta, në Istog në ngastrën kadastrale Nr. P-70806044-00897-2 në ZK Sinajë, Komuna Istog.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe raportit të VNM-së është konstatuar se është bërë lëshim teknik, me ç'rast nuk janë specifikuar kodet e mbeturinave dhe trajtimi i tyre. Andaj, në faqen e 2-të Vendimit me nr. prot.: 25/4875/ ZSP/ /25 të datës 22.09.2025, fjalja:

Të trajtohen vetëm mbeturia spitalore që klasifikohen si të djegshme sipas kodeve të katalogut evropian të mbeturinave (EWC)

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Zëvendësohet me:

Të trajtohen vetëm mbeturina spitalore që klasifikohen si mbeturina spitalore, sipas kodeve të specifikuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave, e të cilat janë:

- 18 01 01 - Mjetet e mprehta (përveç 18 01 03);
- 18 01 03* - Mbeturina, mbledhja apo hudhje e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi;
- 18 01 04 - Mbeturina, mbledhja apo hudhje e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi (p.sh. fashat, mbështjellës gipsi, çarçafa, veshje për një përdorim, pelenat).

Trajtimi i mbeturinave të lartëpërmendura do të bëhen me djegëjes në temperatura të larta.

Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij dhe shfuqizon Vendimin me nr. prot. 24/4875-3/ DMM të datës 21.07.2026.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/4875-3/ ZSP/ /26 datë: 24.08.2026.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Departamentit për Mbrojtjen-e Mjedisit
3. Komisionit për VNM
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Istogut
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Arkivit të MMPH



Bajram Kafexholli

UD Sekretar i Përgjithshëm i MMPH